



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1601 Dt 08.07.2022

Senati i Universitetit "Isa Boletini në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 07.07.2022, mori:

VENDIM

1. Përfundimisht, nenit 19, pika 2 të Rregullores nr. 1667, dt. 28.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM, për konkursin e shpallur më 22.03.2022, shqyrtimi i ankesave ndaj njoftimit, respektivisht vendimeve të Senatit nga Komisioni i Ankesave do të bëhet në periudhën prej 23.08.2022-06.09.2022, por pa e kaluar periudhën prej 175 ditësh nga dita e shpalljes.
2. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Senati i Universitetit, duke pasur parasysh se, stafi i UIBM është në pushim kolektiv, e konsideroi të arsyeshme që periudha e shqyrtimit të ankesave të kandidatëve që kanë aplikuar në konkursin e shpallur më 22.03.2022, të shtyhet si në pikën 1 të dispozitivit të vendimit, me qëllim që stafit të mos u mohohet e drejta e shfrytëzimit të pushimit kolektiv, por pa e cënuar edhe afatin prej 175 ditësh (neni 19, pika. 4, të Rregullores nr. 1667, dt. 28.09.2021 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes, rizgjedhjes dhe avancimit të personelit akademik në UIBM).

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UIBM;
2. Menaxhmentit;
3. Fakulteteve;
4. Zyrës së personelit
5. Komisionit të Ankesave të Senatit
6. Zyrës për çështje akademike
7. Zyrës për informim me publikun


Prof. dr. Alush Musaj
Kryesues i Senatit